



TRANZICION SHPIRTËROR

Vetmia, zbrazëtia, boshllëku janë rehatuar gjithandej hapësirës së saj shpirtërore dhe e kanë rrethuar në gjysmëterrën e mjegullt të oqeanit të ndjenjave të saj të trazuara. Përball ka një pasqyrë të dëmtuar, që e shfaq realitetin në mijëra copëza të vogla e të paqarta. Për më tepër është errësirë. Flokët i ka të shpupuritur, sytë të zgurdulluar, buzët të skuqura. Ka qarë. Ka veshur një fustan të bardhë prej një stofi të lehtë. Shikimin e ka të akullt, por të përqëndruar diku larg në meditimet për një fat të pamëshirshëm, të vendosur në sfondin e një bote, që i ngjajson një xhungle të mbushur me pengesa e hone të rrezikshme dhe egërsira të uritura për një krijesë delikate si ajo. Ajo gjendet përball vetvetes. Për të parën herë në jetën e saj, po përballlet me ndërgjegjen e saj. Po analizon. Po reflekton. Po kupton. Po ndjen. Po përjeton. Po përballon të papërballueshmen. Po ndryshon. Po përshtatet. Po bëhet e fortë.

Fryjnë erëra të forta, që duken sikur vijnë nga jashtë e që përplasen me njëra-tjetrën. Bën një stuhi e madhe, që i trazon gjethet e porsarëna të vjeshtës. Dallgët e detit janë të larta, të tërbuara. Përplasen egërsisht me shkëmbinjtë e thepisur dhe shkumojnë si për të nxjerrë jashtë mllëfin, që i ka fryrë. Shiu i rrëmbyer njom pemët e zhveshura dhe troket ende në portat e zemrës së saj si një ogur, që parandjen të nesërmen e mistershme. Asgjë nuk duket të jetë në vendin e duhur. Janë kohëra të zymta. Rreth e përqark ka vetëm tym. Nuk e di nga erdhi, por është aty.

Por, thuhet, se ku ka tym, ka dhe zjarr. Dhe vërtetë, brenda saj shpërtheu një zjarr flakërrues, që ishte mbajtur i kyçur për shumë kohë. Një zjarr, që i kapërceu të gjitha metastazat e ligjeve të natyrës. Dhe ishte vërtetë mbreslënëse. Një zjarr, që digjej në mes të shiut. Dhe vepronin aq paqësisht, sa askush nuk e pengonte tjetrin të vazhdonte rrjedhën e tij të natyrshme. Bota gjeti ekuilibrin. Ajo zbuloi filozofinë e jetës. Ajo gjeti dritën në mes të errësirës. Ajo dalloi jetën nga vdekja. Ajo gjeti rrugën për të ecur përpara, shkallët që të ngjisin lart. E pastroi shpirtin nga papastërtitë, që i ishin ofruar nga jeta dhe ajo kurrë më parë s'kishte pasur mundësi t'i flakte tej. E hoqi velin e zi, që i kishte burgosur zemrën e pastër dhe nuk e lejonte të merrte frymë lirisht.

Dhe gjithçka ndodhi, sepse ajo gjeti një motiv për të jetuar. Ndoshta jo çdo gjë është aq e keqe sa duket. Mbase thellë-thellë qenies së atyre bishave fshihet një krijesë po kaq e brishtë sa ty, por që ka frikë nga të qenurit vetvetja dhe maskohet nën identitetin e fortësisë dhe bëhet pjesë e falsitetit, që na mashtron kaq padrejtësisht. Por, gjërat nuk janë ashtu si duken. Mos ki frikë! Asgjë nuk zgjat përgjithmonë. Stinët vijnë e ikin. Pas shiut del dielli. Rrezet e tij të arta janë të afta të ngrohin çdo zemër të sëmurë, të shërojnë çdo shpirt të lënduar dhe të kthjellojnë çdo mendje të mjegulluar nga periudhat e ndërlikuara të tranzicionit dhe kolapsit të ndjenjave të shpirtit njerëzor.

Unë e di se ti mundesh. Që nga momenti, kur ti i pranon të tjerët për atë që janë dhe e fillon ndryshimin nga vetja; që nga momenti kur ti mund të falësh çdo padrejtësi, që të është bërë; që

nga momenti kur ti e merr i bindur dhe i ndërgjegjshëm timonin e anijes tënde për të ecur drejt synimeve dashamirëse, ti ke gjetur rrugën e vërtetë të jetës, ke gjetur veten tënde, ke gjetur paqen.

Ndiej një zjarr që më ngroh. Shoh falë një dielli, që ndriçon. Dëgjoj një violinë, që luan hareshëm melodinë e shpirtrave të lumtur e të bashkuar. Kurse një fllad i lehtë i përcjell tingujt e saj deri në kupë të qiellit. Ndiej edhe një aromë shpuese, që ka parfumuar ajrin e freskët të mëngjesit. Në mes të shkretëtirës së thatë ka çelur një lule e vogël, që ka vesë mbi petalet e saj të gjelbra. Ka ardhur pranvera. Jeta vazhdon...

K.K